



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E DREJTESISE**  
**MINISTRI**

**URDHER Nr. 358 date 5/09/2013**

**PER**

**TARIFAT E TRANSKRIPTIMIT TE PROCESVERBALIT TE SEANCES GJYQESORE, TE  
MBAJTUR ME MJETE TE REGJISTRIMIT AUDIO OSE AUDIOVIZIV**

Ne mbeshtetje te nenit 102, pika 4 e Kushtetutes, te nenit 7, pika 2 te Ligjit Nr. 8678, date 14.05.2001, "Per organizimin dhe funksionimin e Ministrise se Drejtesise", i ndryshuar, si dhe nenit 118/1, germa b) te Ligjit Nr. 8116, date 29.3.1996 "Kodi i Procedures Civile i Republikes se Shqiperise", te ndryshuar,

**URDHEROJ :**

1. Tarifat per transkriptimin e procesverbaleve te seances gjyqesore, ne rastet kur transkriptimi behet me kerkese te paleve ne gjykim ose personave te tjere te interesuar, jane si me poshte:
  - a) Transkriptimi i nje fragmenti nga procesverbali i seances gjyqesore - 500 leke;
  - b) Transkriptimi i nje procesverbali te seance gjyqesore - 1500 leke.
2. Transkriptimi me kekrese te trupit gjykues nuk i nenshtrohet tarifes.
3. Paleve ne gjykim ose personave te tjere te interesuar i jepet transkriptimi i procesverbalit te seances gjyqesore, vetem pasi vertetojne pagimin e tarifes se transkriptimit.
4. Ngarkohen gjykatat e shkalles se pare dhe gjykatat e apelit per zbatimin e ketij Urdhri.
5. Ngarkohet Drejtoria e Pergjithshme e Ceshtjeve te Drejtesise ne Ministrine e Drejtesise per ndjekjen e zbatimit te ketij urdhri.
6. Ngarkohet Sekretari i Pergjithshem per njoftimin e ketij urdhri.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere dhe botohet ne Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI**  
**EDUARD HALIMI**